

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	226/23
Nr. i fq. / Br. st	- 8 -
Data: / Datum	13.10.2023
VUSHTRRI - VUČITRN	



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN**

PROCESVERBAL

nga mbledhja e IX-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15 shtator 2023 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloj në ora 10:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Ilmi Azemi, Lorik Maxhuni, Nurie Halili, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehollı dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Gjithashu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Shpëtim Zhegrova (Nënkyetar i komunës), Drejtoret e drejtive, Haki Maloku nga zyra e kryetarit, Fatmir Feka nga Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, si dhe nga sekretaria e kuvendit, Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Ajo tha se na kanë ardhur edhe disa pika shtesë për të cilat kërkoj pëlqimin tuaj që t'i shtojmë në rend të ditës.

Komiteti për Politikë dhe Financa me gjashtë (6) vota “për”, asnjë “kundër” dhe dy (2) “abstenime” aprovoi këtë:

R E N D D I T E

- Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 12.7.2023;
- Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 6.7.2023;
- Shqyrtimi i Projekt – Buxhetit për vitin 2024 dhe parashikimet për vitet 2025-2026;
- Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 24/22 i datës 31.01.2022;
- Shqyrtimi i Informatës përfundimin e korrije – shirjeve për vitin 2023;
- Shqyrtimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësítë natyrore dhe fatkeqësítë tjera në territorin e Komunës së Vushtrrisë, nëntor – dhjetor 2022 dhe janar – shkurt – mars 2023;
- Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi publik me qytetarë;
- Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit për situatën ekonomike - financiare dhe zbatimin e planeve investuese janar - qershor 2023;
- Shqyrtimi i Propozim - vendimit për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e rrugës “Ismail Qemajli” në Vushtrri;
- Shqyrtimi i Propozim - vendimit për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e rrugës “Ismail Qemajli” në Vushtrri;

11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për lirim nga pagesa e taksës për mbeturina;
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për kompensimin e kryetarëve të këshillave lokale;
13. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 12.7.2023.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 12.7.2023.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 6.7.2023.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 6.7.2023.

3. Shqyrtimi i Projekt – Buxhetit për vitin 2024 dhe parashikimet për vitet 2025-2026.

Shpëtim Zhegrova, Nënkyetar i komunës – tha se ky buxhet është më i lartë se i viteve të kaluara për afro 2 milionë. Është e mirë se vitin e ardhshëm subvencionet do të ngriten rreth 400 mijë euro, ku e ka aprovuar edhe Ministria e Financave. E kemi zbritur vlerën nga investimet kapitale dhe i kemi rritu subvencionet, për shkak se po e shohim se çdo ditë po ka nevojë t’iu ndihmohet qytetarëve, tha ai. Sa i përket investimeve kapitale, vlen të theksohet se një pjesë e madhe e buxhetit mund të janë edhe obligime kontraktuale të këtij viti, siç janë: ndërtimi i kanalizimeve që veç janë duke u zhvilluar punimet dhe ka obligime kontraktuale për vitin e ardhshëm. Obligim tjetër kontraktual do të jetë ndërtimi i sheshit, që veç është publikuar. Për ndërtimin e sheshit, janë planifikuar për vitin e ardhshëm afér 800 mijë euro, kurse pjesën tjetër do ta mbulojmë në vitin 2025. Obligim tjetër do të jetë nga ujësjellësi, pavarësisht projektit të ri. Po ashtu, obligimet tjera kontraktuale do të janë edhe rregullimi i lumenjve (Podrança, në Studime dhe Smrekonicë). Obligime tjera kontraktuale për vitin e ardhshëm do të janë edhe rregullimi i rrugës “Bekim Berisha – Abeja” në Begaj, rruga “Avni Saracj”, “Viciana”, “Lumni Surdulli”, “2 Maji”.

Projekte të reja që vlen të theksohet janë: Ndërtimi i urës në Lumadh, ndërtimi i stacionit të pompimit në fshatin Skoçnë. Projektet e bashkëfinancimit me donatorë, nuk është një buxhet i madh, por shpresojmë se të hyrat do të tejkalojen këtë vit dhe do ta plotësojmë këtë kategori, ku e kemi ndërtimin e tregut që është veç në procedurë, fasadimi i objekteve të vjetra në qytet (bashkëfinancim me donatorë), sheshi “Adem Jashari”. Pastaj, ka nevojë për riasfaltim të disa rrugëve që janë në gjendje të mjerueshme. Shëtitorja te palestra sportive, ku po mendohet të ndërtohet tek ura e gurit. Kurse, prapa palestrës sportive po mendojmë t’i ndërtojmë dy fusha të tenisit dhe një shteg për vrapim. Ndërtimi i “sheshit të lirisë”, në vendin ku kanë qenë taksistat. Rregullimi i hapësirave te vendi i quajtuar “liqeni i dynekut”, ku kemi zotim që do të kemi bashkëfinancim nga njëra prej ministrite, ku është një projekt i madh në një hapësirë prej 4 hektarëve që do të ndërtohet një park i madh i qytetit. Si bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës, do të jetë rruga nga ura e Silnicës e deri tek hekurudha në Shtitaricë.

Tek shëndetësia, është planifikuar rregullimi i sporteve, montimi i kaldasë.

Tek kultura, është planifikuar restaurimi dhe konzervimi i arkivit të vjetër, po shpresojmë se do të pajisemi me leje, sepse edhe sivjet kemi të drejt për ta shpallur, rregullimi i memorialin në Gllavatin, ndërtimi i fushave rekreative nëpër fshatra, aty ku kemi hapësira

publike, rregullimi i platosë, rregullimi i tribunave dhe objekteve përcjellëse në stadiumin “Ferki Aliu” etj.

Tek arsimi, ndërtimi i ankesit të shkollës “Mustafë Venhari”, e kemi diskutuar edhe për shkollen “Naim Frashëri”, e cila nuk është në gjendje të mirë. Shkolla në Shtitaricë nuk është në gjendje të mirë.

Këto janë disa prej projekteve të reja, por jemi ende duke punuar tek asfaltimi në fshatra e qytet, ku ende nuk i kemi precizuar, sepse jemi duke i pritur kërkesat.

Rrugët me kubëza në qytet, ai tha se kemi bërë identifikimin e tyre, ku janë afërsisht 38 rrugë.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – tha se ky projekt – buxhet është gjithpërfshirës, transparent dhe në përputhje me Sistemin e Klasifikimit në bazën e parave të gatshme. Jashari tha se buxheti për vitin 2024 do të jetë 26,770,039.00€. Të hyrat vetanake të planifikuara do të janë 3,418,154.00€. Në kategorinë <paga dhe mëditje> kemi 13,209,301.00€, në kategorinë <mallra dhe shërbime> kemi 4,840,000.00€, në kategorinë <shpenzime komunale> kemi 571,000.00€, në kategorinë <subvencione> kemi 1,223,000.00€ dhe në kategorinë <shpenzime kapitale> kemi 6,926,738.00€.

Ai tha se i kemi zvogëluar investimet kapitale dhe i kemi rritur mallrat dhe shërbimet.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – nuk e di a na ka ardhur materiali i kompletuar, apo nuk kanë pasur mundësi me e rregulluar si duhet. Tek planifikimi urban, është rregullimi i rrugëve në fshatra (nr. 10), pastaj edhe në qytet që nuk ka numër fare, kurse kalon tani në numrin 33. Nuk po e kam të qartë këtë. Po ashtu, edhe tek kategoritë tjera, renditja e numrave nuk është në rregull. Për këtë arsyen edhe ka qenë problematike ta analizojmë buxhetin, sepse ka paqartësi. Rruja në Akrashticë vërtetë është në gjendje të mjerueshme, mirëpo këtu u tha që do të rikonstruohet, por unë nuk e pashë që është diku.

Lajm i mirë është që shuma totale për investime kapitale është rritur. Nuk pajtohem me atë që e tha drejtori se i kemi zvogëluar investimet kapitale dhe janë rritur mallrat dhe shërbimet, sepse fshatrat kanë nevojë më tepër për investime kapitale. Për subvencione jemi në rregull, sepse ka nevojë që të rriten dhe të sjellen ide të reja.

Tek asfaltimi i rrugëve, ju kisha rekomanduar që t'i keni prioritet arteriet kryesore të rrugëve në qytet dhe fshatra. E di që ka kërkesa të mëdha për asfaltim për rrugë të shkurta e familjare, ku shumica prej tyre janë private, por të investohet në këto rrugë e me mbet arteriet kryesore nuk është në rregull. Ai tha se dëmtimi i rrugëve po bëhet nga kamionët me peshë të madhe tek punimet në hekurudhë. Prandaj, Drejtoria për Inspekte të ish kanë me mirë me dal me i inspekto kamionët se a kanë të drejtë të bartin pesha të mëdha.

Mirë do të ishte që para seancës të na thërrisni si kuvend për të diskutuar për çështjen e buxhetit, jo në formën e tipit të scancës.

Shpëtim Zhegrova, Nënkyrytar i komunës – theksoi se është e vërtetë që janë ngritur mallrat dhe shërbimet, por tek kategoria e investimeve kapitale kemi një ndryshim, sepse meremetimet do të shkojnë tek kategoria <mallra dhe shërbime>. Se pse nuk i kemi futur edhe rrugët tjera është për shkak se nuk i dimë ende obligimet kontraktuale.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – tha se një çështje tjetër që po na përsëritet vazhdimisht është se disa projekte po përsëriten, nuk e di a s'po mund të kryhen e po duhet prapë të futen në buxhet. Psh. rregullimi i sallës te administrata, sigurisht se fjala është për

sallën e kuvendit. Nëse ka mundësi buxhetore, unë pata propozuar që të ndërtohet një sallë e re.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – sa i përket sallës së kuvendit, tha se ka kërkuar që mjetet të dalin te zyra e kuvendit, e jo të mbresin në administratë.

Shpëtim Zhegrova, Nënkyetar i komunës – lidhur me sallën e kuvendit, ai tha se e dimë që ndërtimi i objektit të komunës është donacion nga Komisioni Evropian dhe në atë kohë kam qenë kryesues i kuvendit. Kisha përshtypjen se do të jetë një sallë dinjitoze, por kur e pashë u befasova, sepse më së paku i ngjanë sallës së kuvendit. E kemi diskutuar edhe me kryetarin dhe me inxhiner, dhe viteve të ardhshme do ta shikojmë mundësinë ta ndërtojmë edhe një kat në këtë objekt, ku besoj se hapësira do të ishte më e mirë dhe më e shfrytëzueshme. Nëse nuk gaboj, komuna e Fushë Kosovës e ka bërë një gjë të tillë, ku e ka ndërtuar edhe një kat, tha ai.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – lidhur me sallën, kur do që të rregullohet, kisha propozuar që ulëset mos të jenë të kapta, por të jenë lëvizëse dhe tavolinat të jenë më të gjera.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me gjashtë (6) vota “për”,asnje “kundër” dhe dy (2) “abstenime” vendosi që ta procedojë për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 24/22 i datës 31.01.2022.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

5. Shqyrtimi i Informatës përfundimin e korrje – shirjeve për vitin 2023.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – kemi marrë informacione nga bujqit se rendimentet nuk kanë qenë të mira. Prandaj, ai kërkoi që të plotësohet informata, duke i paraqitur edhe sfidat me të cilat janë ballafaquar bujqit.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të plotësohet dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

6. Shqyrtimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësítë natyrore dhe fatkeqësítë tjera në territorin e Komunës së Vushtrrisë, nëntor – dhjetor 2022 dhe janar – shkurt – mars 2023.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – tha se vlerësimi i dëmeve është bërë me siguri për ata që kanë bërë kërkësë. Shpresojmë të gjendet ndonjë mënyrë tjetër dhe të bëhet vlerësimi i dëmeve edhe për ata që nuk kanë bërë kërkësë.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – kam kërkuar në mbledhjen e kaluar që të bëhet një komision për vlerësim të dëmeve. Por, në këtë listë nuk po i shoh emrat e personave që janë të dëmtuar, në rrugën “Lidhja e Lezhës”, “Mehmet Konjuhi”. Ky vlerësim është bërë vetëm për qytetarët që kanë bërë kërkesë në komunë, kurse komisioni që kam kërkuar unë nuk është themeluar dhe nuk ka dalë fare në terren. Po ashtu, kam kërkuar që të bëhet pastrimi i asaj lagje (“Lidhja e Lezhës”, “Mehmet Konjuhi”) me një cisternë, por as kjo nuk ka ndodhur.

Shpëtim Zhegrova, Nënkyrytar i komunës – në bazë të legjislacionit në fuqi, vlerësimi i dëmeve bëhet në bazë të kërkesave dhe raporteve që i sjellin qytetarët. Fatkeqësisht, nëse nuk ka ardhur ndonjë kërkesë prej qytetarëve, ne nuk kemi mundur ta dimë se ka pasur dëme. Ai tha se kemi qenë në terren dhe secila rrugë që ka pasur dëme nga vërshimet, jo që është pastruar, por është rregulluar në mënyrën më të mirë të mundshme aq sa kemi pasur mundësi. Nuk e besoj që ka ndonjë rrugë në Vushtrri që ka mbetur në atë gjendje qysh e potencoi Fatmirja. Kemi pasur rast që edhe urën e kemi prishur, vetëm që mos të vërvshohen shtëpitë.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – tha se përveç që nuk janë në listë, kanë bërë edhe kërkesë për vlerësim të dëmeve, psh. Emine Hajra. Kurse, sa i përket rrugës që e ceka, si të kryhet mbledhja kemi me shku bashkë edhe me shiku gjendjen e rrugës. Po ashtu, edhe mbajtëset e urës janë dëmtuar dhe ende nuk janë rregulluar, por as nuk qenkan planifikuar në buxhet, që paraqet rrezik përfshirë.

Shpëtim Zhegrova, Nënkyrytar i komunës – deklaroit se shumë rrugë, por edhe rrugën “Lidhja e Lezhës” e frekuentojmë gati çdo ditë, sepse dalim në terren. Sa i përket urës, fatmirësish na është lajmëruar një kompani private dhe e ka hapur atë urë. Ajo urë në lumin Podrança ka pasur që të ndërrohet krejt (ti ke qenë pjesë e qeverisë komunale), kurse te ura e Kovaçicëve janë hequr vetëm gilinderat, por ata janë rregulluar.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – nëse janë rregulluar gilinderat e urës, po më vjen mirë, por se di si ka pasur mundësi të rregullohen pa qenë fare të planifikuar në buxhet. Kjo ke arsyja që e ngrita si shqetësim, sepse nuk e pashë që janë planifikuar në buxhet dhe desha ta propozojë që të futet në buxhet rregullimi i gilinderave të asaj ure.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

7. Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi publik me qytetarë.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – e pashë procesverbalin, por më shqetësoi fakti që nuk ka ardhur procesverbal i takimit me qytetarë që e kemi pasur ne si kuvend bashkë me ekzekutivin. Po ashtu, nuk i pashë edhe procesverbalet e dëgjimeve tjera buxhetore, në mënyrë që ta dimë se a janë marrë parasysh kërkesat e qytetarëve.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

- Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit për situatën ekonomike - financiare dhe zbatimin e planeve investuese janar - qershor 2023.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – tha se kjo pikë edhe pikat tjera shtesë na kanë ardhur me vonesë dhe nuk kemi pasur mundësi t'i analizojmë. Kurse, vetëm në seancë mund të bëjmë diskutime më përbajtësore.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

- Shqyrtimi i Propozim - vendimit për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e rrugës "Ismail Qemajli" në Vushtrri.

Shpëtim Zhegrova, Nënkyrytar i komunës – theksoi se kemi dy propozime që bëhet fjalë për pronat tek ëmbëltorja "Fibello" dhe prona tjetër është ku ka qenë marketi "te Selacët", afér restoran "Sueno". Prandaj, është interes i komunës që të zgjerohet ajo rrugë.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – deklaroi se këto pika na kanë ardhur me vonesë. Çështja e këmbimit të pronave është e ndjeshme. Pasi që kanë ardhur me vonesë, unë jam sot kundër këmbimeve në KPF. Kurse, për kuvend to t'i analizojmë. Ai tha se në atë lagje, ka ankesa të banorëve ku janë duke u shqetësuar nga ndërtuesit, ku po ua rrëzojnë qytetarëve edhe muret private, rrithojat e oborreve. Për këtë e kam njoftuar një natë në telefon edhe drejtorin e Drejtorisë për Inspektime. Ndërtuesit gjatë ndërtimeve në atë lagje, bëjnë gropë të mëdha, dhe nuk krijojnë siguri për banorët, ku punishtja nuk ka fare rrithoja, pastaj materialin ndërtimor e hudhin në rrugë, gjë që paraqet rrezik për fëmijtë. Në një rast e kam thirr vet policinë, pasi që u shkarkua kamioni me rërë në rrugë dhe u bllokua rruga.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – parafolësi si duket nuk e pati të qartë se ky propozim nuk është i personit fizik apo juridik, por i Kryetarit të komunës, i cili ka vlerësuar se bëhet fjalë për interes të përgjithshëm. Ne duhet ta shikojmë se çka po fiton apo çka po humb komuna. Në këtë rast, po fiton komuna dhe qytetarët, sepse po bëhet zgjerim i rrugës në atë pjesë.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – qëllimin e zgjerimit të rrugës e sqaroi nënkyryetari, por nuk e kuptuam se cila pjesë do t'i ipet ndërtuesve. Nëse iu ipet prona tek "Kaqqanollët", atëherë duhet edhe pëlqimi i atyre banorëve.

Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – tha se komuna e jep një qosh që është i pashfrytëzuar dhe në këtë rast komuna fiton dy herë.

Bujar Pllana, drejtor i Drejtorisë për Inspektime – deklaroi se sa i përket kompetencave të drejtorisë sonë, sapo jemi njoftuar, inspektorët kanë dalë në terren. Kurse, sa i përket sigurisë në punë, kjo është kompetencë e Inspektoratit të Punës.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – faleminderit drejtor Bujar për sqarimin dhe të falënderoj për gatishmërinë që ajo që është në kompetencë të komunës të ndërmarrin masa.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me pesë (5) vota “për”, katër (4) “kundër” rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

10. Shqyrtimi i Propozim - vendimit për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e rrugës “Ismail Qemajli” në Vushtri.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me pesë (5) vota “për”, katër (4) “kundër” rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për lirim nga pagesa e taksës për mbeturina.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – e mbështet këtë propozim, por paraprakisht edhë në mbledhjen e kaluar të KPF-së kam kërkuar që rregullorja për mbeturina të sjelljet në kuvend për plotësim-ndryshim, për arsy se kemi shumë ankesa nga bizneset.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për kompensimin e kryetarëve të këshillave lokale.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – e pashë në propozim – vendim që kompensimi të bëhet nga kategoria <mallra dhe shërbime>. Nuk e di ligjërisht a do të ketë mundësi të bëhet pagesa nga kjo kategori.

Dëshja të pyes se a është bërë pagesa e komisionit të kuvendit që është marrë me zgjedhjen e këshillave lokale?

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

13. Të ndryshme.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – Kam kërkuar në mbledhjen e kaluar raportin e aksionarëve të ndërmarrjeve “Përparimi” dhe “Uniteti”. Nëse vazhdon kjo neglizhencë, atëherë kërkoj nga kuvendi që t’i shkarkojë dhe t’i caktojë disa aksionarë tjerë që janë më të përgjegjshëm.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – pajtohem me Agronin, sepse edhe unë në mbledhjen e kaluar kërkova të na vjen rapporti i punës së ndërmarrjes “Përparimi”, njëkohësisht të na vjen edhe një raport i numrit të të punësuarve, gjegjësisht listës së të punësuarve që nga janari 2022, por edhe nga janari 2023 ta shohim se si është gjendja, gjë që u zotua edhe Kryetari i komunës së në mbledhjen e radhës do të vjen ky raport. Por, ja që nuk është proceduar. Prandaj, po e ripërsëris që të na vijnë këto raporte të ndërmarrjeve.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – pasi që drejtoresha e urbanizmit nuk është e pranishme, po kërkoj që të më jasin përgjigje me shkrim se: A janë pajisur me leje lojërat e vendosura në rrugën “Ismail Qemajli”? Nëse jo, në çfarë forme kanë operuar?


Bujar Pllana, drejtor i Drejtorisë për Inspektime – deklaroi se lojërat kanë qenë të vendosura në pronë private dhe se në kësot raste nuk mund të lëshohet pëlqim.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – e kam ngrit këtë shqetësim në seancë, por drejtoresha e urbanizmit deklaroi se kanë aplikuar për leje, por po i mungon një dokument. Prandaj, ajo kërkoi përgjigje me shkrim nga Drejtoria për Urbanizëm.

Shpëtim Zhegrova, Nënkyrytar i komunës – kërkoi që të mbahet një seancë e jashtëzakonshme për buxhetin më datë 25 shtator 2023, për shkak se seanca e rregullt është më datën 28 shtator dhe se Drejtoria për Financa ka shumë punë për plotësimin e formularëve për t'i dërguar në ministri. Prandaj, ai kërkoi mirëkuptimin e anëtarëve të KPF-së që kjo seancë të mbahet më herët në mënyrë që të ketë kohë më shumë për stafin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

Mbledhja përfundoi në orën **11:35**.

Bujar Klinaku



Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi



Kryesuese e KK-së dhe KPF- së